

Forumi i Investimeve BE-Ballkani Perëndimor



EU - WB6
INVESTMENT FORUM
TIRANA ► 13 - 14 OCTOBER 2025



Në kuadër të Forumit të Investimeve EU-WB6, u zhvillua aktiviteti IPAs Connect, që bashkoi agjencitë e promovimit të investimeve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfaqësues të BE-së, RCC-së dhe Bankës Botërore.

Qëllimi kryesor: forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e investimeve të huaja direkte.

Më shumë në faqen 2

Forumi i investimeve Shqipëri - Turqi



Më 17 tetor, në Pallatin e Kongreseve, u mbajt Forumi i Investimeve Shqipëri-Turqi 2025, organizuar nga AIDA dhe MÜSİAD Albania, që mbledhi përfaqësues qeveritarë, investitorë dhe sipërmarrës nga të dy vendet.

Më shumë në faqen 3

Dita e parë e Forumit të Investimeve EU-WB6

Forcimi i bashkëpunimit mes agjencive të promovimit të investimeve në Ballkanin Perëndimor IPAs Connect çeli siparin e këtij eventi dyditor, duke bashkuar përfaqësues të agjencive të promovimit të investimeve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfaqësues të Bashkimit Evropian, Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Bankës Botërore.

Qëllimi kryesor i aktivitetit ishte forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e investimeve të huaja direkte në rajon. Në fjalën e saj, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, theksoi se bashkëpunimi rajonal, përparimi në reforma dhe besimi në institucionet evropiane janë elementë kyç për tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Ballkanit Perëndimor.

Agjencitë prezantuan kornizat ligjore, prioritetet e investimeve dhe sfidat që hasin në tërheqjen e investitorëve të huaj.

Ndërkohë, agjencitë evropiane të promovimit të investimeve nga Gjermania, Franca, Italia, Hungaria dhe Qiproja ndanë përvojat e tyre të suksesshme në ndërtimin e politikave të qëndrueshme dhe mbështetjen e investitorëve. Ky shkëmbim përvojash u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërmjet agjencive të rajonit dhe pozicionimit të Ballkanit Perëndimor si një destinacion i përbashkët investimesh.



Memorandum Mirëkuptimi – Rrugë të reja për bashkëpunim rajonal


Në përfundim të takimit mes Agjencive të Promovimit të Investimeve të Rajonit, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) midis Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë së Promovimit të Investimeve të Bosnjë dhe Hercegovinës (FIPA).

Ky memorandum synon forcimin e bashkëpunimit institucional dhe nxitjen e iniciativave të përbashkëta, që do të lehtësojnë zhvillimin e projekteve të reja investimi dhe rritjen e ndërveprimit ekonomik në rajon.

Një hap më pranë Europës!

Në kuadër të Forumit të Investimeve EU-WB6, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, firmosi deklarata të përbashkëta bashkëpunimi me synimin për të forcuar lidhjet ekonomike dhe për të promovuar Ballkanin Perëndimor si një destinacion të përbashkët investimesh.

Mundësi të reja bashkëpunimi dhe investimesh për një rajon më konkurrues.



Dita e dytë e Forumit të Investimeve BE-Ballkani Perëndimor

AIDA: Shqipëria po bëhet gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj!

Në ditën e dytë të Forumit të Investimeve EU-WB6, më 14 tetor në Tiranë, u zhvilluan panelet sektoriale që trajtuan mundësitë e investimeve në fushat prioritare të rajonit:

Lëndët e para kritike, Energjia, Transformimi Digjital, Bioekonomia dhe Sektori i Mikpritjes & Ekonomia Qarkulluese.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në panelin e Mikpritjes dhe Ekonomisë Qarkulluese, ku Drejtoresha Ekzekutive, znj. Laura Saro, prezantoi reformat dhe politikat e reja që e bëjnë Shqipërinë një destinacion gjithnjë e më tërheqës për investitorët e huaj.

“Ne i ndihmojmë investitorët të kuptojnë proceset dhe afatet e lejeve. Shqipëria është bërë më fleksibël dhe më e hapur ndaj investimeve të huaja,” – u shpreh znj. Saro.

Znj. Saro theksoi se AIDA ofron shërbime këshilluese dhe procedura të thjeshtuara, duke siguruar që çdo projekt të zhvillohet në përputhje me legjislacionin dhe parimet e transparencës.

Forumi i madh Shqipëri-Turqi – Vizion i përbashkët për zhvillim dhe stabilitet

Më 17 Tetor, në Pallatin e Kongreseve u mbajt Forumi i Investimeve Shqipëri-Turqi 2025, organizuar nga AIDA në bashkëpunim me MÛSIAD Albania.

Ngjarja mbledhi përfaqësues qeveritarë, investitorë dhe sipërmarrës nga të dy vendet, duke forcuar bashkëpunimin ekonomik dypalësh.

Në hapje morën pjesë Znj. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministre e Shqipërisë, dhe Z. Cevdet Yilmaz, Zëvendëspresident i Turqisë, të cilët nënvizuan synimin për dyfishimin e tregtisë dhe zgjerimin e investimeve. Ministria Delina Ibrahimaj prezantoi shifrat më të fundit të investimeve të huaja dhe rolin e kompanive turke në Shqipëri.

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s theksoi rëndësinë e këtij forumi si platformë për dialog, ide dhe partneritete strategjike, duke e cilësuar atë si një kapitull të ri në partneritetin ekonomik Shqipëri-Turqi.



–Në hapjen e Forumit Shqipëri-Turqi 2025, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik dhe vizionit të përbashkët për zhvillim.

Ajo u shpreh se Shqipëria po ndryshon me shpejtësi, duke ofruar mundësi, siguri dhe transparencë për investitorët, ku çdo investim shihet si pjesë e zhvillimit kombëtar.

“Investitori nuk është thjesht vizitor ekonomik, por partner në zhvillim. Dhe partnerët nuk i lëmë kurrë vetëm,” – theksoi znj. Saro.

Ajo njoftoi gjithashtu se së shpejti do të lançohet një platformë online për investitorët e huaj, që do të ofrojë informacion dhe udhëzime në kohë reale mbi tregun dhe projektet në Shqipëri.

“Kur vizioni bashkohet me vullnetin, suksesi është rezultat i sigurt,” – përfundoi znj. Saro.

–Në një mesazh online, Kryeministri Edi Rama theksoi angazhimin e qeverisë shqiptare për të krijuar një klimë të favorshme për investitorët dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik rajonal.

Ai vlerësoi marrëdhëniet e jashtëzakonshme Shqipëri-Turqi, të cilat kanë sjellë rritje të ndjeshme të shkëmbimeve tregtare – nga 250 milionë euro dhjetë vite më parë në mbi 1 miliard euro vetëm në nëntë muajt e parë të këtij viti.

Kryeministri e përshkroi Shqipërinë si një “ishull mundësish”, me taksa të ulëta, energji të gjelbër dhe sektorë në zhvillim si turizmi dhe teknologjia, duke e cilësuar vendin si partner strategjik të Turqisë dhe urë drejt Bashkimit Europian.

Ai e përmbylli mesazhin me thirrjen:

“Le të ndërtojmë së bashku autostradën e suksessit nga Bosfori në Adriatik.”

–Në fjalën e saj në Forumin Shqipëri-Turqi 2025, Zëvendëskryeministrja Belinda Balluku theksoi avantazhet konkurruese të Shqipërisë për investitorët dhe potencialin e sektorëve strategjikë si turizmi, ndërtimi dhe teknologjia.

Ajo vuri në dukje partneritetin e fortë mes Shqipërisë dhe Turqisë, të bazuar në besim të ndërsjellë dhe vizion të përbashkët për zhvillim e stabilitet rajonal.

“Shqipëria nuk është vetëm një destinacion turistik, por gjithnjë e më shumë një destinacion për biznesin,” – u shpreh Balluku.

–Në fjalën e saj në Forumin Shqipëri-Turqi 2025, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, theksoi rëndësinë e marrëdhënieve të forta ekonomike mes dy vendeve, të ndërtuara mbi besimin dhe respektin reciprok.

Ajo prezantoi të dhënat e fundit, sipas të cilave investimet e huaja direkte në Shqipëri kanë arritur në 759 milionë euro, ndërsa Turqia renditet e para me 11.7% të totalit.

Aktualisht, 578 biznese me pronësi turke dhe 88 sipërmarrje të përbashkëta operojnë në sektorë strategjikë si ndërtimi, energjia, turizmi dhe teknologjia.

“Ky bashkëpunim është një histori suksesi dhe një vizion i përbashkët për zhvillim të qëndrueshëm,” – u shpreh ministrja Ibrahimaj.

Forumi i Biznesit i Procesit të Berlinit

Forumi i Biznesit i Procesit të Berlinit: AIDA prezantoi potencialin e investimeve në Shqipëri

Në Forumin e Biznesit të Procesit të Berlinit, i hapur me panelin "Investimet në Ballkanin Perëndimor", Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Laura Saro, prezantoi kuadrin e investimeve dhe mundësitë që Shqipëria ofron për investorët e huaj.

Znj. Saro theksoi reformat që kanë krijuar një klimë të qëndrueshme dhe transparente për biznesin, si dhe roli aktiv i AIDA-s në lehtësimin e procedurave dhe orientimin e investorëve gjatë gjithë procesit të investimit.

Ndër sektorët prioritarë u veçua tranzicioni i gjelbër, me objektivin që deri në vitin 2030 energjia diellore dhe ajo e erës të përbëjnë 30% të prodhimit kombëtar të energjisë.

Ajo gjithashtu nënvizoi stabilitetin ekonomik të Shqipërisë dhe përfshirjen e vendit në sistemin SEPA, si një hap konkret drejt integritetit të plotë financiar me Bashkimin Europian.

Paneli, bashkorganizuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe Departamenti i Tregtisë dhe Biznesit i Mbretërisë së Bashkuar, mbledhi përfaqësuesit e gjashtë Agjencive të Promovimit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor, UK Export Finance dhe investorë ndërkombëtarë.

Diskutimet u përqendruan në projektet strategjike rajonale, tranzicionin e gjelbër dhe bashkëpunimin për zhvillim të qëndrueshëm, si elementë kyç për nxitjen e investimeve dhe integrimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor.



AIDA mirëpriti Ambasadoren e Republikës Socialiste të Vietnamit

AIDA pati kënaqësinë të presë në një takim zyrtar Ambasadoren e Republikës Socialiste të Vietnamit, Znj. Pham Thi Thu Huong.

Gjatë takimit, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Saro, ndau informacion mbi klimën e investimeve në Shqipëri, prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe roli që AIDA luan në nxitjen e investimeve të huaja.

Të dyja palët shprehën vullnetin për të thelluar marrëdhëniet ekonomike dhe për të krijuar ura të reja bashkëpunimi.



Shqipëri-Itali: AIDA dhe ICE nxisin partneritete investimesh

Gjatë muajit Tetor, drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Laura Saro, mirëpriti z. Matteo Picariello nga Agjencia Italiane e Tregtisë (ICE), së bashku me atasheun ekonomik të ambasadës italiane, z. Mario De Rosa, për të çuar më tej bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Italisë.

Takimi u fokusua tek investimet dhe partneritetet strategjike, duke hapur mundësi të reja për shkëmbim eksperiencash dhe projekte të përbashkëta, si dhe duke mbështetur investorët shqiptarë dhe italianë.



AIDA mirëpriti një delegacion me 8 kompani polake

AIDA priti në një takim Ambasadorin e Polonisë në Shqipëri, Z. Wojciech Unolt, si dhe një delegacion prej 8 kompanish polake që operojnë në sektorët e energjisë së rinovueshme, pasurive të paluajtshme, teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjes.

Takimi u fokusua tek marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe, bashkëpunimin e frytshëm ekonomik si dhe shkëmbimin e informacioneve mbi realizimin e projekteve të investimit në këta sektorë.

Kompanitë polake shprehën interes për të investuar në Shqipëri, duke sjellë teknologji moderne dhe praktikat më të mira në fushat e tyre të veprimtarisë



AIDA pjesë e Tirana SLUSH'D 2025: Shqipëria, ylli i ri i inovacionit

Më 30 Tetor, në Innovation Hub – Piramida, Tiranë, u zhvillua edicioni i dytë i Tirana SLUSH'D, ngjarja kryesore për startup-e dhe inovacion në vend.

AIDA mori pjesë aktive në këtë event, me Drejtoreshën Ekzekutive, znj. Laura Saro, në panelin "Albania - The Next Rising Star", ku u prezantua vizioni për një ekosistem inovativ që nxit:

- Investime
- Kreativitet
- Zhvillimin e talenteve shqiptare

Znj. Saro theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes startup-eve dhe investorëve për të krijuar mundësi të reja biznesi dhe për të përforcuar pozicionin e Shqipërisë si qendër inovacioni në rajon.

Ngjarja gjithashtu ofroi një platformë për rrjetëzim dhe shkëmbim ideve midis aktorëve kryesorë të ekosistemit të teknologjisë dhe sipërmarrjes.



AIDA mori pjesë në ABSL Western Balkans Conference 2025, 23-24 Tetor

ABSL Maqedonia e Veriut në Konferencën e Ballkanit Perëndimor 2025

Më 23-24 tetor, ABSL Maqedonia e Veriut bashkëorganizoi Konferencën ABSL për Ballkanin Perëndimor 2025 në Sarajevë, duke mbledhur mbi 200 liderë rajonalë dhe ndërkombëtarë për të diskutuar rritjen e sektorit të shërbimeve të biznesit nën temën: "Zhbllokimi i potencialit: urat ballkanike për ndikim global".

Pjesëmarrja e AIDA-s në këtë event theksoi se kjo ishte një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer njohuri me kolegët rajonalë dhe për të kontribuar në formimin e një peizazhi më tërheqës dhe të harmonizuar të investimeve në Ballkanin Perëndimor.

Ngjarja nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, tërheqjes së investimeve dhe zhvillimit të talenteve në Ballkanin Perëndimor.



AIDA në Panairin Ndërkombëtar A+A 2025, Hall 12, Stenda 12C81

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me SIPPO Albania, do të përfaqësojnë Shqipërinë për herë të dytë në A+A 2025, që do mbahet në Düsseldorf, Gjermani, 4-7 Nëntor 2025.

Pjesëmarrja në A+A 2025 ofron një platformë për të promovuar cilësinë, fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë e industrisë shqiptare të veshjeve të punës, veshjeve mbrojtëse, uniformave dhe veshjeve speciale në tregjet evropiane.

Në stendën e Shqipërisë do të jenë të pranishme pesë kompani prodhuese të këtij sektori:

- Abatex shpk
- N.D Albania shpk
- Blue Sky Ltd
- Maxbrand
- Marlotex shpk

Urojmë suksese dhe arritje të vlefshme për kompanitë shqiptare pjesëmarrëse në këtë panair ndërkombëtar.

Për më shumë informacion shkarkoni broshurën këtu: <https://lnkd.in/dem6JUDw>

AIDA nis sezonin e ri “Investor Support Days”- Swiss Day, 05 Nëntor

Për vitin e dytë radhazi, nisim “Investor Support Days”, gjatë periudhës nëntor–dhjetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, ambasadat e huaja dhe dhomat bilaterale të tregtisë.

Këto evente ofrojnë mundësinë për takime direkte me zyrtarët tanë, diskutime mbi sfidat dhe mundësitë e biznesit tuaj, si dhe vizita në terren për të parë nga afër proceset e kompanive tuaja.

Jeni investitorë që ushtroni aktivitetin në Shqipëri?

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se më datë 5 nëntor 2025 do të zhvillohet “Dita e Investitorëve Zviceranë” (Swiss Day) në kuadër të Investor Support Days, në bashkëpunim me Dhoma e Tregtisë Zvicër–Shqipëri (SWISSA).

 Data: 5 nëntor 2025

 Ora: 11:00

Vendi: Pranë zyrave të AIDA-s, Rruga “Skerdilajd Llagami”, Godina 1, H.6, Tiranë

Ky event do të trajtojë sfidat dhe mundësitë që hasin kompanitë zvicerane që operojnë në Shqipëri, me fokus në përmirësimin e klimës së investimeve. Ngjarje të tilla janë të dedikuara për ju – ndaj ju ftojmë të ndani eksperiencat dhe të diskutoni mbi rrugët drejt rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit ekonomik.



Programi “Beyond Borders”, 24–26 Nëntor

Nëse je drejtues kompanie në sektorin IT apo BPO, tani ke mundësinë të forcosh aftësitë dhe vizionin që të çojnë drejt tregjeve globale.

Programi Beyond Borders, i krijuar nga GIZ dhe Reinvantage, të ndihmon të ndërtosh një kulturë organizative me vizion ndërkombëtar, të komunikosh përtej kulturave dhe të fitosh besimin e klientëve globalë.

Gjatë programit do të dëgjosh ekspertë nga Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA, do të krijosh lidhje me profesionistë të tjerë dhe do të mësosh si të prezantosh biznesin tënd me qartësi, vetëbesim dhe kulturë globale.

 Online + në Tiranë, 24–26 Nëntor

 Pjesëmarrja është falas për drejtuesit e kompanive në sektorët IT dhe BPO

 Regjistrohuni tani : <https://lnkd.in/e5vTVtm7>



ECGE – Platformë për Bashkëpunim Rajonal, 29–30 Tetor 2025

Energjia, ndërtimi dhe ekonomia e gjelbër në fokus! ECGE 2025 rikthehet në Tiranë si platforma kryesore rajonale që nxit inovacionin, bashkëpunimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Panairi ECGE shërben si një pikë kyçe lidhëse mes Shqipërisë dhe rajonit. Me pjesëmarrjen e kompanive nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Greqia dhe Italia, ky aktivitet krijon terren të favorshëm për bashkëpunim ndër-rajonal në sektorë strategjikë.

Përfaqësues nga institucione publike dhe private marrin pjesë në forume të nivelit të lartë, ku trajtohen sfidat dhe identifikohen zgjidhje të përbashkëta për zhvillimin energjetik dhe ndërtimin e qëndrueshëm në rajon.

Edicioni i vitit 2024 ilustron qartë rritjen dhe ndikimin e ECGE me rezultate konkrete:

- 70+ ekspozues nga sektorët e energjisë së rinovueshme, ndërtimit, konsulencës dhe teknologjisë;
- 2,500+ vizitorë, ndër të cilët 55% përfaqësues biznesesh nga rajoni;
- 40+ folës në panele dhe diskutime tematike;
- Pjesëmarrje rajonale nga Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi;
- Interes i shtuar nga kompani ndërkombëtare që e konsiderojnë Shqipërinë si portë hyrëse në tregun ballkanik.

Këto të dhëna dëshmojnë jo vetëm suksesin e deritanishëm të ECGE, por edhe potencialin e tij për të ndikuar pozitivisht në diskursin ekonomik dhe zhvillimet sektoriale në nivel rajonal.

AIDA ju fton të merrni pjesë në- “Food Expo”, në datat 14-16 Mars 2026, Athinë, Greqi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) do të jetë pjesë e panairit ndërkombëtar FOOD EXPO 2026, që do të zhvillohet në Athinë, Greqi, më 14-16 mars 2026, duke përfaqësuar Shqipërinë me një stand të dedikuar për produktet shqiptare.

Ky panair është një mundësi e shkëlqyer për kompanitë shqiptare për të:

- ✓ Zgjeruar tregjet e eksportit dhe arritur blerës ndërkombëtarë
 - ✓ Krijuar bashkëpunime B2B dhe lidhje strategjike me distributorë dhe importues
 - ✓ Promovuar produktet tradicionale dhe të përpunuara, duke përfshirë vaj ulliri, bulmet, produkte bio, produkte me emërtim të mbrojtur të origjinës (PDO), mish, peshk, ëmbëlsira dhe pije tradicionale
- FOOD EXPO është lider në ekspozitat e Ushqimit dhe Pijeve në Evropën Juglindore, duke bashkuar mbi 1,300 ekspozues, 200 pjesëmarrje ndërkombëtare, rreth 35,000 vizitorë profesionistë, dhe mbi 11,000 takime B2B midis prodhuesve dhe blerësve ndërkombëtarë.
- Kompanitë e interesuara për të qenë pjesë e standës shqiptare duhet të dërgojnë shprehjen e interesit në: info@aida.gov.al, brenda datës 13 nëntor 2025.
- Mos humbisni mundësinë për të promovuar produktet “Made in Albania” në një prej eventeve më të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit ushqimor dhe për të rritur prezencën tuaj në tregjet globale!

Për më shumë informacion rreth panairit, vizitoni faqen zyrtare <https://foodexpo.gr/en>



Akses në Financë- AIDA ju informon për thirrjen RESILMESH OPEN CALL 2

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: RESILMESH OPEN CALL 2.

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/resilmesh-open-call-2>

Aida pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Tiranës, edicioni i 31-të

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) do të jetë pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Tiranës, edicioni i 31-të, me stenda të dedikuara ku vizitorët dhe bizneset do të kenë mundësi të informohen për shërbimet që ofron AIDA, projektet strategjike dhe mbështetjen për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (SME).

🌐 Krijoi lidhje, zbuloni mundësi bashkëpunimi dhe eksploroni zhvillimin ekonomik të Shqipërisë!

📅 5-8 Nëntor 2025
📍 Pallati i Kongreseve, Tiranë

